



VENDIM

Nr. 11 Datë 06.02.2012

**PËR
MODIFIKIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE ME SERI PV10K, NR. 104, LESHUAR ME VENDIM TE
BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE-S NR. 51, DT. 05.07.2010 PËR
SHOQËRINË WENERG SH.A**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 gërma “b”, pika 4 gërmat “a” dhe “b”, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.02.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WENERG” sh.a për ndryshimin e liçensës Nr. 104, Seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 51, datë 05.07.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "WENERG" sh.a, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”** : Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë liçensën me nr. 104, Seria PV10K, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec "Dardha 1" me fuqi 4 MW, të shoqërisë "WENERG" sh.a, të miratuar me Vendimin e Bordi i Komisionerëve Nr. 51, date 05.07.2010.
2. Fuqia e instaluar e Hec "Dardhë 1" nga 4 MW të bëhet 5.8 MW.
3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI